



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-9199/23
Kaçanik, 19.04.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IV (katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 28.04.2023 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 28.04.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti tre mujor financiar, Janar-Mars 2023;
3. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime;
6. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7 në ZK Duraj, për Këmbim me pjesën e Parcelës kadastrale 00411-0 ZK Duraj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.60/01-7162/23
Kaçanik, 31.03.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III(tretë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 mars 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin fillimisht 26 anëtarë, në ndërkohë arriti edhe anëtarja Fitore Vishi, kështu që konstatohet se prezentë ishin 27 anëtarët – të gjithë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti- DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri –Selimi dhe Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL. Për shkaqe teknike, kjo mbledhje nuk mund të transmetohet drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 26 anëtarë, për momentin nuk është vetëm Fitore Vishi. Kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e III (tretë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 31 mars, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2023;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;
4. Kërkesa e Antigona Axhami-Baftijaj, Fiknete Kransiqi, Edita Shehu, për dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

Para se me kaluar në shqyrtimin e pikave të rendit të punës, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli ua përkujtoj anëtarëve të KK se është dita e fundit e afatit për Deklarimin e pasurisë.

Jeni të vetëdijshëm për pasojat ligjore që na presin nëse nuk e deklarojmë pasurinë, kështu që të keni parasysh çështjen e deklarimit të pasurisë në afatin e përcaktuar ligjor.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri me vërejtjen e z. Agim Mani, të diskutimi i tij të pika 3, ku është shënuar shuma 201 mijë duhet të jetë 212 mijë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së II (dytë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 27.02.2023 / Lënda: 01Nr.60/01-4155/23.

Procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Në emër të Grupit të Grave Asambleiste-GGA, shprehi shqetësimin lidhur me një kërkesë jo formale të kryesuesi i KK, e cila përmes tij i është drejtuar Zyrës për Barazi Gjinore, pastaj kërkesa zyrtare i është drejtuar Kryetarit të Komunës. Përgjigja ka qenë se është çështje e vonuar kërkesa jonë. Kërkesa ka qenë për një aktivitet simbolik për Ditën e Gruas, 8 Marsin. Kjo datë nuk ndryshon, ndërkaq si nuk është menduar ndonjë aktivitet në shënim të kësaj date, pos një kafe në byfe me punëtorët e komunës. Ne-GGA e realizuam një aktivitet në Policinë e Kosovës dhe QKMF me vet financim të zonjave asambleiste, por është jo korrekte se si mundet komuna të injoroj si aktivitet dhe mos të bëjë publike në faqen e komunës. Një injorim i tillë, iu bëjmë thirrje t' mos të përsëritet. Si kryetare e GGA, falënderoj të gjitha gratë asambleiste në angazhimin e tyre për realizimin e aktivitetit të realizuar.

znj. Kadrije Lika-Troni: Edhe pse jemi në ditën e fundit të muajit mars, me duhet të kthehemi në fillim të muajit, për me elaboruar një temë që shpresoj se do të keni uruar dhe mbështetur të gjithë, përveç kryetarit. 8 Marsi njihet si Ditë e Gruas në tërë botën, madje në shtete të ndryshe kjo festë festohet si ditë ndërkombëtare. Kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim bindje politike e fetare kulturore, gjuhe e prejardhje, por edhe të përkujtuar përpjekjet e grave në të gjitha fushëveprimet e tyre. Për nder të 8 Marsit, GGA ishin koordinuar për me bërë vizita në institucione të komunës tonë, si: QKMF dhe Stacionin Policor të Kosovës, me qëllim që t'i falënderojnë dhe t'iu ofrojmë përkrahjen tonë morale institucionale për gratë heroína që shërbejnë në këto dikastere, në këtë rast edhe shpërndarjen e dhuratave simbolike me rastin e festës së 8 Marsit. Kërkesa jonë iu drejtua Kryetarit të Komunës për me mbështetur iniciativën tonë me mjete financiare, por hasi në veshë të shurdhër, dhe ne e kuptuam se kërkesa është dashur të bëhet 1 muaj me herët. Jo që nuk na mbështetën financiarisht, por as edhe një urim nuk doli nga Zyra e Kryetarit. Këtu kemi të bëjmë me neglizhencë dhe mos planifikim nga komuna, duke shkuar edhe me larg, diskriminimin direkt gjinor nga kryetari dhe ekzekutivi për me shënuar apo festuar 8 Marsin. Se është vepruar në të njëjtën mënyrë, në vijim po listoj disa nga çështjet të cilat i kemi ngritur në muajt e fundit ne si LVV, e kryetari dhe ekzekutivi kanë vepruar njëjtë duke i përsëritur gabimet vazhdimisht, sepse keq menaxhoni dhe keq planifikoni. Se Zyra për barazi gjinore, është e mangët, kur drejtohet vetëm nga gjinia mashkullore; Se tetori është muaj për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit, ku komuna heshtë; Se duhet shtohet në rend të ditës, 16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore; Se shfuqizuam vendimin sepse nuk është respektuar kuota gjinore. Gjatë fushatës zgjedhore, keni dhënë shumë premtime për projektet që do t'i realizoni për gratë, ndërkaq tani kur e keni pushtetin, i keni harruar premtimet. Shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjitha gratë asambleiste, ku me vet financim ia arritëm të shënojmë 8 Marsin dhe të realizojmë planin tonë. Ia bëjmë me

dije kryetarit se nuk ka limit që na kufizon neve grave, me i realizuar qëllimet tona. Sa me tepër hapësirë që lejohet gruas në shoqërinë tonë, aq me i suksesshëm dhe më i prosperuar do të jetë komuna dhe vendi, se gratë e qytetit tonë meritojnë me shumë. Gratë tona nuk meritojnë një qeverisje diskriminuese.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju kisha lutur, kur të merrni fjalën për pyetje dhe kërkesa, të jeni sa me të shkurtër dhe sa me konkret. Në këtë rast, ka mundur me qenë pyetja: Pse nuk janë ndihmuar aktivitetet tona për festën e 8 Marsit? Nuk ka nevojë me bërë elaborime, ne mundemi me caktuar pikë të rendit të ditës për çështje të caktuara dhe me debatuar me gjerë, jo vetëm në këtë rast, por edhe për raste tjera, se po dalim jashtë kontestit për atë që jemi thirrur. Të jeni me të shkurtër dhe me konkret në pyetje dhe kërkesa, ndërkaq elaborimet t'i lëmë për hera tjera.

z. Adnan Reka: Para se të kaloj në pyetjet dhe kërkesat të cilat kam menduar me i ngitë, kërkoj një sqarim me shkrim se në çfarë formule është kalkuluar paga ime ? Unë për këtë arsye po e theksoj edhe publikisht se nuk e nënshkruaj listën e pagave pa e marrë një sqarim me shkrim. Listën e muajit shkurt e nënshkruaj, ndërsa atë të muajit mars nuk e nënshkruaj pa marrë ndonjë sqarim.

Pyetje për kryetarin:

1. Pse komuna e Kaçanikut nuk i publikon kontratat në platformën E- Prokurimi, për kundër kërkesave ligjore dhe thirrjes se vazhdueshme të KRPP?

2. Pse komuna e Kaçanikut, për kundër obligimeve që ka, nuk ofron qasje në dokumente të tenderëve që kërkohet, sipas kërkesës për qasje në dokumente publike?

Kryesuesi i Kuvendit: Tani me njoftuan nga DBF, që ka ndryshime përsëri të pagave të anëtarëve të KK. Në pagën e shkurtit e kanë marrë edhe mëditjen, ndërkaq tani është vetëm paga bazë. As drejtorja nuk kishte ndonjë sqarim, sigurisht iu ka ardhur nga qendra, besoj se ditëve në vijim sqarohen me ndonjë Udhëzim Administrativ-UA, se a do të marrin mëditje anëtarët e KK apo vetëm pagën bazë, se edhe për neve është e paqartë. Ndërkaq, anëtarët e KK të cilët janë me paga primare dhe sekondare, nuk e di se qysh kalkullohet paga.

z. Selajdin Troni: 1. Kam një kërkesë nga banorët e lagjes Trupi, që në rrugën “2 Korriku”, të shqyrtohen mundësitë buxhetore për ndërtimin e rrjetit të ndriçimit publik.

2. Kërkoj nga drejtorja e Arsimit t'i shikoj mundësitë ligjore për ndarjen e shkollës –paraleles fizike në Kovaçec nga shkolla amë e fshatit Bob, pasi janë plotësuar kushtet. Shkolla e Kovaçecit ka hapësirën shkollore të jashtme dhe të brendshme për me funksionuar e pavarur.

z. Naim Beça: Paraqiti shqetësim për çështjen e kubzave këtu përballë ndërtesës, se distanca mes kubzave është e madhe. Parashatroj pyetje se, a duhet komuna çdo vit me intervenuar në rregullimin e atyre kubzave ? Ky projekt duhet punohet me mjeshtëri shumë të mirë, me u rregulluar kjo çështje një herë e përgjithmonë.

z. Bashkim Luma: Unë i kam disa pyetje, të cilat mund t'i vlerësoni si kërkesa apo ankesa:

1. Pagesat e parapara për transport të nxënësve, pse nuk ekzekutohen në afatin e përcaktuar me rregullore prej 15 ditësh? Kjo pyetje me është bërë nga operatori privat.

2. Përse edhe pas 5 muajve, komuna nuk ka lidhur kontratë për mirëmbajtjen e ndriçim publik?

3. Përse në shkollën “Gafurr Luma”, nuk ka kuadër adekuat për lëndët: Kimi dhe Fizikë ?

4. Përse nuk bëni asnjëherë mbikëqyrje të projekteve të realizuara nga kompanitë, kryesisht të projektet kapitale? Projektet kalohen pa mbikëqyrje përfundimtare, gjë që po dalin menjëherë probleme të reja në terren.

6. Përse komuna nuk ka investuar në ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve në Globoçicë, pasi kjo rrugë është e frekuentuar çdo ditë edhe nga nxënësit?

7. Edhe sa kohë iu duhet me u marrë me projekte të vogla, që nuk janë të kushtueshme ?

z. Rustem Zenuni: E kam një kërkesë për anëtarët e KK: Në fund të mbledhjes të bëjmë një foto të përbashkët në shenjë mbështetje të “Marshit për Drejtësi” i cili organizohet në mbështetje të Çlirimtarëve të cilët po gjykohej në Hagë. Neve na kanë thënë me iu bashku të gjithë qytetarët organizatave. Marshi organizohet nga OVL e UÇK, kështu t’iu dalim në përkrahje se jemi në mbështetje të çlirimtarëve të cilët po gjykohen në Hagë padrejtësisht, dhe duhet demonstrojmë në këtë marsh që po organizohet.

z. Adnan Reka: Nëse është fjala për organin e KK, unë personalisht e përkrahi kërkesën e juaj, ndërkaj nëse është fjala për dy organet, kuvendin dhe ekzekutivin, nuk pajtohem se ne jemi dy organe të ndara.

z. Rustem Zenuni: Foto në përkrahje të “Marshit për Drejtësi”, do të behet vetëm me anëtarët e KK.

Kryetari i Komunës: Ne si organ ekzekutiv kemi realizuar me herët foto për qëllimin e caktuar (në përkrahje të “Marshit për Drejtësi”).

z. Agim Çaka: Lidhur me përgjigjet të cilat i kam marrë, për çështjen e ndriçimit publik të qytetit, përgjigja e DSHPE është se, komuna është në pritje të lidhjes së kontratës. Çka d.m.th. kjo dhe sa zgjatë kjo pritje ? Ndriçimi publik ka probleme që tre (3) muaj, sidomos në hyrje të qytetit, të kalaja. Duhet investuar në këtë drejtim, ashtu që me i vendosur dritat me të mira, e me ia shtuar një pamje me të mirë qytetit.

1. Të projekti i ndërtimit të hekurudhës, e kemi ngritur si shqetësim, për punët të cilat janë duke u kryer dhe problemet të cilat po dalin për qytetarët të cilët kalojnë atypari. Përgjigja na është dhënë, se do të rregullohet. Unë nuk e di qysh shkojnë punët, megjithatë mendoj se komuna duhet me pasur qasje në këtë projekt. Komuna e paska në plan me bërë një nënkalim nën hekurudhë të ETC-a, vetëm për këmbësor. A ka me u bërë edhe për makina ai nënkalim ku kalojnë këmbësorët, apo si do të jetë ? Kjo çështje mbetet përsëri me pasur sqarime të nevojshme në mbledhjen vijuese.

2. Çështje tjetër të cilën e kam ngritur, është për projektin e rrugës Runjevë-Stagovë, i cili projekt ka dështuar për momentin. Edhe këtu paska pasur disa probleme ligjore, si çështja e ofertuesve, ankesat. Tenderi i ka takuar ofertuesit që ka dhënë çmimin me të ulët, e që duhet të jetë ashtu, ndërkaj me intereson të di: Pse OSHP ka rënë në kundërshtim me atë që kanë vendosur këtë çështje? Cili është problemi mes tyre? Sepse, si rezultat i kësaj, del se projekti ka dështuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

2. Propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2023;

Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kur jemi të mjetet e bartura të vitit 2021 dhe 2022 në buxhetin e vitit 2023, kanë ngelur mbi 814,000€ dhe mbi 200,000€ në suficit buxhetor, ndërkaj ka kërkesa të mëdha të qytetarëve të cilat nuk janë realizuar. E përmendi edhe Bashkimi se në f. Gilloboqicë, nuk është e shtruar asnjë metër trotuar, ndërkaj në anën tjetër barten mjete. Shuma e mjeteve mbi 814,000€, e mira e vetme e kësaj është se e rritë buxhetin e vitit 2023, ndërkaj me mirë ka qenë me u shpenzuar këto mjete, sesa me u rritë buxheti. Nëse vazhdohet ky trend, apo kjo mendësi e qeverisjes, atëherë nga viti 2023-2024, kemi me bartur mjete nga të HVK të

pashpenzuara mbi 1 milion euro. Këtë po e themi duke marrë për bazë tre vitet e fundit, që mjetet e bartura kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Është papërgjegjësi e ekzekutivit kjo mbetje e mjeteve. Ekzekutivi i komunës i mbledhë mjetet nga pagesat e shërbimeve administrative dhe pagesat e tatimit në pronë. Për pagesat e tatimit në pronë, qytetarët të cilët nuk kanë mundësi me paguar me kohë, sanksionohen me paguar me gjobë, ndërkaq në anën tjetër, barten mjete nga viti në vit. Kjo nënkupton se në vitin 2022 ka mundësi me u bartë disa mjete, ndërkaq ato të vitit 2021 janë bartura në vitin 2022 dhe nuk janë shpenzuar dhe përsëri bartën në vitin 2023, kjo është papërgjegjësi. Shpërndarja e mjeteve që bëhet në kode buxhetore, janë 249,000€ të cilat mjete janë të paalokuara. Fillimisht është dashur të alokohen- rialokohen, pastaj të shpërndahen në kode të caktuara buxhetore. Janë futur edhe disa kode të reja, pse nuk i keni planifikuar me buxhetin e vitit 2023 këto kode të reja, por i keni futur tani. Ne për hir të projektit, nënkalimit hekurudhor, për mos me ikur procedura, ne LVV do të votojmë Për.

z. Adnan Reka: Me bartje të mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake, është paraparë një nënkalim hekurudhor me shumën 241,000€. Ne do të mbështetim këtë propozim, por pas shumë përgjigjeve të cilat i morëm nga ekzekutivi, lidhur me këtë nënkalim, projekti për rehabilitimin e segmentit hekurudhor është dashur të filloj dhe përfundoj, 2019-2022, gjë të cilën qeveritë pararendëse nuk e kanë realizuar. Si rrjedhojë e këtij projekti, ekzekutivi i komunës është dashur shumë me herët të kenë qasje shumë me pro aktive, të kenë plan dhe një projekt të detajuar për një vendkalim për automjete dhe këmbësor apo vetëm për njërin nëse të dyja ishin të pamundura, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka ky vendkalim për ato lagje dhe numrin e madh të nxënësve mbi 1 mijë nxënës që kalojnë atypari me shkuar në shkollë. Komuna jonë po e lejon ndarjen e qytetit dhe po i fragmenton komunën tonë për çdo vit e më tepër. Me tepër keni qenë të interesuar me favorizuar një biznes të caktuar, sesa të bëni zgjidhje për nxënësit dhe qytetarët e komunës, për të cilët keni obligim moral dhe ligjor. Pse në vitin 2023 nuk e keni paraparë këtë projekt kaq të rëndësishëm, por e keni futur një kod të ri buxhetor prej 5.000€, duke paraparë një urë milionëshe që kalon mbi lumin neredime dhe hekurudhë, shkëputur nga PZHK në vitin 2020, të cilin ju kurrë do të ndërtoni, por tentoni t'i manipuloni disa qytetarë, kinse qeveria aktuale nuk po na jep përkrahje. Pyetja është: Ku ishit gati që 15 vite, apo pasi të përfundoj projekti iu bien ndërmend, sikurse të hyrja në autostradë, mini- hidrocentralet në lumin lepenc apo të ky projekt që gati ka përfunduar. A po mjaftojnë me futur kode me shumën 5000€, si për impiantin për trajtimin e ujërave të zeza apo ndërtimin e urës mbi lum dhe hekurudhë, për t' mos i realizuar kurrë.

z. Naim Beça: Projekti i hekurudhës ka filluar në vitin 2019, ndërkaq tani që po i bartim mjetet e vitit 2021 dhe 2022, a e keni ditur që ka me u realizuar ky projekt? Ne duhet ditur qysh ka me qenë ai nënkalim, a ka me pasur drita, sa ka me qenë i gjatë dhe i gjerë nënkalimi? Me realizimin e këtij projekti, rrethimi me tela apo qysh ka me qenë, gjysma e qytetit ka me qenë e burgosur, sepse nuk mundemi me kaluar me vetura. Ky është akt historik, pasojat i shohim në vijim. Ne duhet të ngritëm e të protestojmë duke u nisur nga Kryetari i Komunës, e mos me lejuar një gjë të tillë, se ky është një akt historik për të gjithë qytetarët e Kaçanikut dhe për region. Para 200 viteve është bërë plani me i mirë sesa tani. Nëse lejojmë me u bërë ky projekt, kanë me na akuzuar qytetarët. Pyetja është: Ku keni qenë nga viti 2019 kur është bërë projekti për hekurudhë. Nuk është në rregull në mes qytetit me u bërë nënkalimi për këmbësor e jo edhe për vetura dhe nuk është në rregull që dikush e ka shkollën 100 m, me u sjellë me km. Unë jam shumë i emocionuar për këtë çështje, sa që nuk po mundem as me u shprehur si duhet.

Kryesuesi i Kuvendit: Mendoj se nëse dikush nuk ka informata me mjaftueshme, dikush nga ekzekutivi, ka. Kontaktet e komunës me atë të infrastrukturës, pozita gjeografike dhe lumit përreth, besoj se është studiuar, është bërë studimi i fizibilitetit, nuk e di a ka mundësi apo jo me u ndërtua nënkalimi. Me mirë është që nënkalimi me qenë edhe për vetura, besoj se kryetari jep sqarime me të hollësishme.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Është ngritur një temë e cila është shqetësuese edhe për ne, për juve si opozitë dhe qytetarët. Është e vërtetë se projekti i autostradës është nga 2019, por ne deri me tani nuk e kemi ditur që është projekti detal i INFRAKOS, se nuk na janë përgjigjur asnjëherë, pos që kanë ardhur me kërkuar vendkalime. Unë deri para 4-5 muajve kur e kam pasur takimin me zëvendësministrin, nuk kam mundur me kuptuar me kaluar hekurudha përmes qytetit, dhe nuk iu lihet qasje qytetarëve pas 130 viteve, në një hekurudhë të re. Unë kam menduar që nëpër qytete, qytetarët kanë me pasur një qarkullim të lirë për hyrje dalje deri në stacion, gjë që nuk kam besuar, kjo është vërejtur në momentin e fundit. Unë kam kërkuar qasje nëpër pjesën tjetër të qytetit të Kaçanikut ku mundemi me i bërë nga 2-3 rrugë, se nuk mundemi me bërë çdo kund laura për shkak të shpejtësisë së trenit. Unë nuk kam besuar për një hekurudhë pas 130 vjetëve në formën si është duke u ndërtuar, e që pos pragjet e drurit po zëvendësohen me ato të qimentë. Ky projekt është i qeverisë, nuk po themi se i kësaj qeverie, fajtorë janë ata të qeverisë së mëhershme, megjithatë është dashur me pa se diçka nuk është në rregull dhe me shikuar me riparuar. Në momentin kur ne e kemi pa se diçka nuk është në rregull – se nuk ka qasje për qytetarët e komunës së Kaçanikut, se paku kemi kërkuar një nënkalim. Kjo është e kushtueshme, ne nuk kemi mundësi me realizuar, iu kemi drejtuar MI se çka mundemi me bërë në këtë drejtim. Ata na kanë thënë se nuk kemi mundësi se është shumë vonë. Në bashkëpunim me zëvendësministrin i cili ka qenë në Kaçanik, ne i kemi shqyrtuar mundësitë tona me mjete vetanake me bërë një nënkalim. Është për t'u habitur sesi pas 130 vjetëve me ndërtuar një autostradë moderne të quaj, e cila bien midis qytetit, ndërkaq nuk iu lënë një qasje qytetarëve- nënkalim. Mundësia jonë është kjo: Kërkesat i kemi bërë me kohë, takimet i kemi pasur të rregullta, ndërsa ne nuk e kemi ditur absolut se çka është duke bërë INFRAKOS, se ajo ka qenë në lidhje direkt me qeverinë. Kjo po shihet se në asnjë komunë nuk kanë lënë nënstacione, e kemi pa të arsyeshme se paku një nënkalim për këmbësorë. Mundësia jonë është kjo. A është me e mira apo me e keqja nuk e di, por kjo ka qenë si ide se çka mundemi me bërë, këtë e kemi diskutuar edhe me zëvendësministrin. A është ide e qëlluar apo jo, ajo është diçka tjetër.

z. Naim Beça: Kryesorja është Kaçaniku është burgosur me këtë nënkalim vetëm për këmbësor. Ia kemi nisur me nënshkrime, faza e parë është me fillimin e protestave, pastaj kjo bëhet lajm ndërkombëtar. Tek e fundit, mllëfin e qytetarëve nuk ka fuqi në botë që mundet me ndalë. Mos të presim të bëhet lajm ndërkombëtar, me thanë që Kaçaniku nuk është duke lënë trenin me kaluar atypari. Kjo është e patjetërsueshme, se Kaçaniku bllokohet se nuk dihet sa trena kalojnë në ditë dhe mundet me u krijuar tollovi në mes të qytetit të Kaçanikut. Kaçaniku duhet me bërë një protestë radikale e mos me i lënë me punuar, unë jam i pari i cili dal në protestë, se nuk është në rregull me u bllokuar një komunë në shekullin 21, kjo nuk ndodhë në asnjë shtet të botës.

z. Adnan Reka: Nëse thoni kryetar se nuk e kemi ditur për projektin e hekurudhës, atëherë pse në vitin 2023 e keni futur në prioritet projektin e urës mbi lumin neredime dhe mbi hekurudhë, kur ky projekt është në prioritet nga viti 2002. A nuk jeni marrë fare me këtë çështje, nuk iu ka interesuar ky problem? Arsyetimet e juaja kryetar përmes viktimizimit i kemi shumë të njohura si me çështjen e kyçje ç kyçje në autostradë, çështjen e hidrocentraleve mbi lumin e lepenç, pastaj çështjen e impiantit, të cilat pasi të kryhen shprehni keqardhje që nuk keni mundur me marrë veprime, por në fakt ju po lejoni çdo gjë e keqe me i ndodhë komunës, sepse komuna për çdo ditë po falimentohet, bllokohet, e ju në fund dilni para qytetarëve me arsyetim se e ke dërguar një letër tek organet kompetente.

Kryetari i Komunës: Të jap një përgjigje Naimit, se pyetjet e delegatit tjetër nuk qojnë peshë shumë. Ne e kemi edhe çështjen e autostradës, e njëjta gjë na ka ndodhur edhe atëherë, iu kemi bërë kërkesë ministrisë. Kërkesa jonë po themi se është shumë vonë, edhe Vitia e ka bërë të njëjtën kohë kërkesë, dhe iu ka realizuar. Kjo është, kur donë e realizon, kur nuk donë nuk e realizon. Ne edhe pse vonë, e kemi bërë një kërkesë të tillë, ndërkaq nuk kemi menduar që në qytet mos me pasur një hyrje dalje për qytetarë me kaluar në pjesën tjetër, por ata e kanë paraparë një gjë të tillë. Mundësitë e tona janë këto, përndryshe nuk themi që është vonë, se

komunat tjera kanë depërtua. Ne e kemi pasur çështjen e autostradës, për të cilën as nuk na kanë pyetur. Ka pasur protesta përmes peticioneve të qytetarëve në KK, përmes apeleve. Të projekti i hekurudhës, ne mundemi me i shfrytëzuar të gjitha format, është projekt qeveritar, ndërkaq mundësitë tona janë këto që janë. Nuk dua me thënë asgjë me tepër as me u viktimizuar, jemi në pushtet me këtë dije të vogël apo të madhe, me këtë dije që na kanë vlerësuar qytetarët.

z. Adnan Reka: Kryetar, ju çdo herë duhet me pyetur vetën se çka jemi duke bërë si komunë, e jo çka bëjnë të tjerët, se çdo herë arsyetohesh në atë se, nuk po bëjnë ata të qeverisë asgjë për neve.

Kryesuesi i Kuvendit: A është vonë, asnjëherë nuk është vonë për me bërë një punë. Ferizaj tani është duke e bërë nënkalimin e hekurudhës, por i kanë mjetet. Ne si komunë duhet pas parasysh se, a i përballon buxheti i komunës tonë nënkalimit me përmasa çfarë po bisedojmë dhe supozojmë. Sigurisht të gjithë jemi të vetëdijshtë se nuk mundemi me bërë me buxhetin që kemi një nënkalim të përmasave të tilla, që kushton 6-7 milion. Çështja është, ndaj kujt po proteston? Atë ditë që të organizohet protesta edhe unë Naim vijë me ty, por çështja është ndaj kujt po protestojmë? Është projekt i INFRAKOS në bashkëpunim me ministrinë e Infrastruktursë. Interes i të gjithë neve është, me u bërë nënkalimi në komunën tonë. Ferizaj e ka realizuar se i ka pasur mjetet, edhe pse LVV në Ferizaj ka qenë kundër dhe ende i akuzon, d.m.th. keq me realizuar një projekt, keq mos me realizuar. Me mirë është me realizuar, por çështja është me gjetur formën. Cilëndo variante që gjendet, unë e pranoj, por çështja është e mjeteve, mjete nuk po na japin, kështu ne me këto mjete të cilat i kemi po mundohem me realizuar këtë projekt. Unë vet kam kërkuar me u bërë nënkalimi edhe për vetura, kanë thënë që ministria së bashku me INFRAKOS e kanë bërë studimin e fizibilitetit, kanë thënë se ka një kosto shumë të lartë, për shkak të ujërave që janë aty. Nëse ne e bëjmë një projekt i cili nuk është i zbatueshëm, nuk kemi bërë asgjë. Unë iu kam thënë edhe për nënkalimin për këmbësor, nëse nuk i bëhet një dranzhim i mirë, ka me qenë jo funksional edhe për qytetarë. Besoj të studiojnë mirë dhe të realizojnë mirë, përndryshe kushdo që gjeni ndonjë formë dhe mundësi për me ia arritur qëllimin, e themi edhe publikisht se unë jam me ju.

z. Naim Beça: Infrastruktura bëhet në formën me të mirë me ua lehtësuar jetën qytetarëve, pavarësisht kush është në qeveri. Se çka thotë INFRAKOS neve nuk duhet me na interesuar, se teknika ka përparuar, bota ka përparuar sa që po bëhen ndërtime të larta në ujë, ndërkaq ne nuk po mundemi me bërë një nënkalim në tokë.

Kryesuesi i Kuvendit: Krejt janë të mundshme Naim, vetëm mjetet ku me i marrë.

z. Naim Beça: Ju jeni në pozita udhëheqëse dhe duhet shqyrtoni mundësitë për gjetjen e mjeteve buxhetore. Është problem i juaj, a hyni në kredi apo a shkoni në qeveri me kërkuar mjete, ajo është çështje e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Kredi u maur për çështjen e impiantit, por e njëjta u anulua.

z. Naim Beça: Kredia për impiantin u anulua, sepse ka pasur shkelje. Ju jeni me na kryesuar neve kryesues, ju nuk jeni për me mbrojtur askënd. Ne duhet me u bërë bashkë e me shkuar në INFRAKOS (fjala është për me protestuar).

Kryesuesi i Kuvendit: Kur të doni, unë jam i gatshëm me shkuar se bashku me ju në INFRAKOS.

Ardita Rrahmani: Nuk është ferr ky debat i zhvilluar nga legjislativi e as nga ekzekutivi. Masat radikale që po përmenden, unë nuk e di çka janë këto masa, a janë kërcënim apo çka janë? Këtij debati unë mendoj se po i kontribuon një mos sqarim nga ekzekutivi i komunës. Ka anëtarë të KK që besoj se nuk e kuptojnë se për çka po bëhet fjalë, 3 apo 4 anëtarë të KK e dinë ndoshta se për çka po bëhet fjalë, ndërkaq 20 anëtarë tjerë mund të mos e kuptojnë se për çka po bëhet fjalë. Nuk është në rregull me na sjell diçka me votuar, për diçka që dikush

është d akordua, ndërkaq 3-4 vetë tjerë me i kontribuar këtij debati, e të tjerët mos me ditur se për çka është fjala. Ky është terr informativ. A ka ndonjë kush në komunë që është përgjegjës që vjen me pajisje të nevojshme, laptop e projektor, që po e kërkon sa herë z. Çaka, për të cilën pajtohemi krejt këtu? Janë 241 mijë euro, ndoshta nuk janë shumë për një tunel, por për komunën tonë janë shumë. Nuk jam kundër, se mundet projekti me kushtuar 500 mijë euro, por duhet t 'na bindeni se është krejt në rregull. Tjetra, korzo e qytetit, nuk e di sa metra është, 150 metra apo me tepër, janë 2 laura, pse nuk po e cekni që janë 2 laura, pastaj nuk e cekni ndërtimin e urës mbi lumë dhe hekurudhë. Jeni duke na lënë pa informatë, se jeni të pa aftë me na dhënë informatë. Për këtë është ky debat, nganjëherë edhe eskalon, se ju nuk jepni informatë të saktë, ndërkaq ne nuk e dimë, 2-3 vetë këtu e arsyetojnë në atë mënyrën e vet, mirë e keq, mbetet tjetër kush me vlerësua. Jepni informatë se kanë me u bërë 2 laura. Jepni sqarim, se jemi fokusuar vetëm të një pikë, ndërkaq për laura askush nuk e përmend. Unë mendoj se pjesa dërmuese e KK nuk e kanë as idenë me të vogël se për çka flitet, mundeni me i pyetur edhe ju.

Kryetari i Komunës: Ne Arditë jemi duke biseduar për një nënkalim, nuk jemi duke biseduar për laura, se jemi sqaruar me herët për 2 laura, se ato janë aprovuar me herët. Çka kanë bërë të hekurudha, aty ku janë 3-4 rrugë që kanë kaluar hekurudhën nëpër fshatra, janë duke i mbledhur duke i bërë ka dy apo tre rrugë me një, me bërë rrugë një kahe, për shkak se shpejtësia e trenit në të ardhmen mendohet me u rritur. Ne sot po bisedojmë vetëm për nënkalimin, dhe nuk është keq që thoni se nuk e kuptojnë të gjithë. Kaçaniku e meriton me pas një nënkalim edhe për vetura, por që kostoja është shumë e madhe, duke filluar nga shpronësimet dhe thellësinë lumit neredime që menjëherë është refuzuar, se nuk e ka paraparë me kohë për shkak të kostos. Në Ferizaj ka kushtuar 7.5 milion një nënkalim, ndërkaq të ne nëse llogaritet edhe shpronësimet dhe thellësia në lumin neredime, është një kosto shumë e madhe që ne nuk kemi mundësi me mbuluar. Vullneti ekziston, por me buxhetin të cilin e kemi është e pamundur. Krejt çka ne kemi bërë, ka lindur ideja për një nënkalim të këmbësorëve, për shkak të frekuentimit të nxënësve, se ka nxënës edhe të shkollës fillore dhe parashkollor që vijnë nga ajo anë dhe nëse ata e shohin laurën, kanë me qenë të pakujdesshëm me kaluar. Ministria nuk na ka ndihmuar, ndërkaq ne nuk e kemi paraparë në planifikim, atëherë jemi detyruar me mjete tona me bërë një nënkalim. A kemi bërë mirë apo keq, nuk po themi që jemi duke bërë me të mirën e mundshme. Unë, kur ju me thoni për një projekt se nuk është duke u bërë mirë, nuk ka cilësi të mirë, jam me ju, por mos kërkon diçka për të cilin nuk e kam takatin me bërë. Nuk është puna me kërkuar diçka para të tjerëve sa për të thënë, ne bëjmë kode për projekte me pak mjete duke shpresuar në investime nga ministria, por nuk na kanë ndarë mjete, ndërkaq ka komuna të vogla që kanë investuar në projekte. Janë 18 komuna që qeveria nuk na i ka proceduar asnjë cent, por kështu ka përzgjedhur ajo qeveri që e kanë votuar qytetarët, ajo mendon se po e bënë me të mirën e mundshme, ndërkaq për ne mendoj se nuk është duke e bërë me të mirën e mundshme. Unë nuk kam menduar që komuna e Kaçanikut për tre vitet asnjë cent nuk ka me pasur nga qeveria, por kjo ka ndodhë dhe mund të ndodhë edhe në vitin vijues. Llogaritini me një buxhet prej 2 milion të komunës me kërkesa marramendëse, me një relief të ashpër, por prapë jam fajtor për ekzekutime të projekteve dhe për cilësi të punës, por jo me kërkuar atë çka nuk kam mundësi me realizuar. Unë kam menduar këtë projekt, ndërkaq për projektet madhore, jam duke i lënë kërkesat e gatshme, në momentin që realizohen, janë të mirë ardhura për komunën e Kaçanikut, pjesën tjetër na takon si ekzekutiv i komunës. Nuk jam duke u viktimizuar, por po ju tregoj se këto janë mundësitë e komunës së Kaçanikut, se edhe kush të vjen pas meje, këto janë mundësitë që mundet me i bërë për projekte, por nuk ka mundësi me bërë me tepër sesa mjetet që i ka për prioritete. Me kritikoni sa të doni, se edhe unë jam me rritur cilësinë, disiplinën për punë, por mos kërkon diçka që nuk mundet me u bërë. Mundësia është ky nënkalim, a është me e mira e mundshme, këto janë mundësitë tona. Ideja ka ardhur në momentin e fundit, alternativa tjera nuk kemi pasur dhe jam pajtuar. Edhe një herë po e themi se unë nuk e kam menduar që në mes të qytetit ku kalon hekurudha, nuk ka me pasur qasje për qytetarët, por kjo na ka ndodhur.

z. Adnan Reka: A e keni ditur në PZHK të vitit 2010 se çka keni me PZHK, pse e proceduat në vitin 2023, ndërtimin e urës mbi lumin lepec dhe hekurudhë. Këto nuk i keni ditur apo nuk keni dashur me i ditur, apo i keni lënë për një arsye në vitin 2023. Pse nuk i keni proceduar prej vitit 2010 këtë projekt që kanë qenë me PZHK. Ne sikur me hidrocentralet mbi lumin lepec, kyçje në autostradë dhe këtë projekt, pasi të kryhet projekti, duhet me dalë e me thënë se, nuk mundem me realizuar për shkaqe të arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Në vitin 2022 nuk ka hyrë në prioritet çështja e tunelit, se ka pasur projekte tjera.

z. Agim Çaka: Duhet të jemi të kujdesshëm e mos të akuzojmë njëri tjetrin, se dikush në të ardhmen mundet me na akuzuar neve për vendime të rëndësishme. Projektet e mëdha, autostrada, hekurudha mund të bëhen 1 herë në 100 vjet. Ne duhet me insistuar me çdo kusht me pasur qasje, ndërkaq a ia arrijmë qëllimin, ajo është diçka tjetër. Nëse ne nuk marrim veprime me u bërë një projekt i tillë, askush nuk vjen me folur për komunën tonë. Si Kaçanik historikisht kemi qenë të shkelur në këtë drejtim, dhe për këtë tani vijmë në këtë pikë. Ne dhe ata që vijnë pas neve kemi me diskutuar gjithë kohën për mungesën e një kyçje në autostradë, se është turp i madh Kaçaniku mos me pasur një kyçje në autostradë. Të Guri i shpëm, ata që i bëjnë projektet, e dinë sa lehtë është me u lidhur në autostradë. Ne edhe me projektin e vjetër të hekurudhës kemi pasur telashe, ku ka pasur pasoja në njerëz, dritat të lura nuk kanë funksionuar. Me projektin e ri, ne duhet pasur parasysh se ka me pasur me tepër qarkullim të trenave. Tani edhe kërkesat e qytetarëve janë shumë me të mëdha sesa kanë qenë, qarkullimi i njerëzve dhe makinave është me i madh për nevojat të ndryshme. Ne duhet në këtë rast me i harruar nevojat e lluksit, se kur niset treni nga Hani i Elezit, këtu veç lëshohet lura, 15 min. i duhet dikujt me prituri deri të kalon treni. Shtrohet pyetja: Çka ka me bërë dikush që ka punë urgjente, ose ndihma e shpejtë ? Për këtë duhet menduar me gjetur një alternativë për ata që kanë raste urgjente e të ngjashme. Duhet me pasur një diskutim të hapur, me shikuar mundësinë për një zgjidhje të mirë, e jo qysh të fajësojmë njëri tjetrin. Nuk jam duke fajësuar as nivelin qendror e as atë lokal, e jona është me insistuar dhe me ditur se çka po kërkojmë. Me bërë një nënkalim ashtu siç duhet, i cili iu shërben edhe qytetarëve dhe automjeteve se paku për rastet emergjente, se nevojë ka komuna jo për një por për dy nënkalime. Planet dhe projektet me i bërë me kohë, ndërkaq a na epët mundësia apo jo është diçka tjetër. Kjo temë duhet me u diskutuar shumë herë, deri sa të arrijmë qëllimin.

z. Betim Shala: U tha se është vlerësuar projekti i nënkalimit se kushton shtrenjtë edhe për vetura e këmbësor. A mundemi ne me ditur sa është ndryshimi i kostos, se në bazë të asaj që u tha, 5-6 milion kushton projekti i nënkalimit për vetura e këmbësor, ndërkaq vetëm për këmbësor e 221 mijë euro, po i vjen 20 herë me shtrenjtë, që është e pa logjikshme. Unë mendoj se nuk është ashtu, ndoshta edhe është, se unë mendoj se me 1 milion euro e mbërrimë realizimin e projektit. Kur është bërë plani i fizibilitetit për vetura, a është bërë edhe për këmbësor? A është llogaritur si do të vjen ura, sepse aty ka me ardhur një urë mbi lumin neredime, se duhet me qenë një kthesë bukur e madhe aty. Qysh ka me ardhur kjo, nëse nuk bëhet nënkalimi për vetura. Të ndërtimi i hekurudhës, unë e parashoh si problem terminalin që është duke u bërë në rrugën “Skënderbeu”, se është jashtë PZHK, ndërkaq unë mendoj se është dashur të ndërtohet me jashtë qytetit.

Kryetari i Komunës: Sipas parashikimeve, vlera e projektit mund të jetë mbi 280 mijë euro. Ferizaj e ka bërë pjesën e parë nën hekurudhë për vetura, i ka kushtuar 430 mijë euro, se e ka bërë me emergjent duke llogaritur thellësinë, veç hekurudhën me kaluar kushton 430 mijë euro, është tenderuar dhe është duke punuar kompania, kurse pjesa tjetër e nënkalimit kushton 7.5 milion euro. Ky është dallimi edhe te ne, marrë parasysh që ne kemi me bërë edhe shpronësime, kur dihet vlera e shpronësimeve, aq kushton edhe të ne ky projekt, ndoshta edhe më tepër.

z. Betim Shala: Një pjesë e pronës është e hekurudhës, dhe nuk ka nevojë për shpronësime, pjesa të rruga “Skënderbeu” është pjesë e hekurudhës.

Kryetari i Komunës: Nënkalimin ne e kemi menduar të pjesa lartë dhe ka qenë me e arsyeshme, por tani ka ardhur kjo zgjidhje këtu poshtë, nënkalimi vetëm për këmbësorë.

z. Qamil Stagova: Ky nënkalim do të ndërtohet në mes të ETC dhe Stacionit hekurudhor. Gjerësia është 4 metra, lartësia 2.40 metra, gjatësia 35 metra. Për hyrje dhe dalje përdorën shkallet dhe rampat. Të Shkolla dhe të Ura e konakut mbetet të përdoret laurë. Është paraparë në projekt edhe largimi i ujërave atmosferik, për shkak se nënkalimi bien nën një pjesë të lumit neredime, ndërkaq mbikalim mundet me u bërë edhe pasi të bëhet hekurudha.

z. Naim Beça: Kush e ka vendosur që të jetë të pjesa e ETC dhe Stacionit hekurudhor, a ka pasur mundësi tjetër ?

z. Adnan Reka: Nga viti 2010-2023, pse nuk është futur në kod buxhetor ky projekt, dm.th nuk është futur në prioritet si kod buxhetor as me shumën 5.000€, se e keni mbajtur të fshehtë këtë çështje ?

z. Naim Beça: Pyetje: 1. A mundem me bërë si pikë të rendit të ditës, çështjen e këtij projekti, Ndërtimin e nënkalimit hekurudhor, sepse ky projekt është madhor për komunën tonë, ndërkaq në mungesë të informatave të mjaftueshme, ne jemi në terr informativ ?

2. A e keni autoritetin e juaj ligjor kryetar, me ia ndërprerë punën INFRAKOS?

Kryetari i Komunës: Jo nuk e kam autoritetin, se as nuk na pyesin, vetëm na njoftojnë. Fuqinë me të madhe e kanë vetëm qytetarët dhe unë jam me qytetarët. Njëjtë kanë vepruar edhe me autostradën, vetëm na kanë njoftuar. Kush është i interesuar mundet me shkuar në zyre me parë projektin të drejtori.

Kryesuesi i Kuvendit: Si informatë mundet DUKMM me sjellë, projektin e nënkalimit të këmbësorëve në hekurudhë dhe laurat sesi janë paraparë.

z. Qamil Stagova: Për nënkalimin po, ndërkaq për laura, kjo është në kompetencë të INFRAKOS.

z. Naim Beça: Është mirë me sjellë këtu në KK projektin me pa sesi duket.

Kryesuesi i Kuvendit: E vërtetë Naim, por nuk po kemi kushte.

znj. Ardita Rrahmani: Duhet me i krijuar kushtet, ne jemi duke kërkuar me sjellë një TV se po na duhet në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Do të mendojmë me blerë një TV për KK. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit, me 26 votë për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Raif Kasa. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2023/ Lënda: 01Nr.400/01-7056/23.

3. Propozim Vendimi për miratimin e Iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;

Kryesuesi i Kuvendit: Ligji për bashkëpunim ndër komunal kërkon procedura, duke nisur nga KK, pastaj kryetari e kthen përsëri në KK për miratim, për të gjitha komunat që mendojnë të bashkëpunojnë mes veti. Informata që na ka dhënë drejtori është nga komunat e regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt, të cilat kërkojnë bashkëpunim me të gjerë ndërkomunal. E hapi diskutimin:

